



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0262

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga panelisti individual, Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE Cactus Sh.a., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” me numër të prokurimit; 206-25-90-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, më 11.06.2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Cactus" Sh.a. me nr. 2025/0262, e datës 11.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN”, me numër të prokurimit; 206-25-90-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË.

2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN”, me numër të prokurimit; 206-25-90-2-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE "Cactus" Sh.a i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.01.2025, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontrat B05, për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” me numër të prokurimit 206-25-90-2-1-1.

Me 24.03.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE Data ProgNet Sh.P.K., për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” me numër të prokurimit 206-25-90-2-1-1.

Me 27.03.2025, OE Cactus Sh.a., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 04.04.2025.

Me 11.04.2025, OE Cactus Sh.a., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0262, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Cactus Sh.a., janë parashtruar si në vijim:

Të nderuar anëtarë të OSHP-së, Përmes kësaj deklarate, dëshirojmë të ofrojmë një përmbledhje të shkeljeve të bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues në rastin konkret. Siç mund ta verifikoni edhe nga provat e bashkangjitura në këtë dosje, më datë 24.03.2025 kemi marrë njoftimin për anulimin nga kjo procedurë e prokurimit, duke shprehur paknaqësinë tonë me këtë njoftim dhe me eliminimin tonë nga kjo procedurë, më datë 27.03.2025 kemi ushtruar një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në të cilën kemi paraqitur të gjitha provat dhe dëshmitë që vërtetojnë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse. Më datë 04.04.2025 kemi marrë vendimin nga Autoriteti Kontraktues, ku jemi njoftuar se kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar në tërësi. Ajo që është më shqetësuese në arsyetimin e këtij vendimi është se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë përpjekje për të ofruar argumente bindëse për pretendimet që kemi ngritur. Për shembull, në lidhje me pretendimin ankimor se stafi duhet të jetë i veçantë për secilin lot, Autoriteti nuk ka ofruar asnjë arsyetim për këtë, ndonëse, siç e kemi cekur edhe në kërkesën për rishqyrtim, në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është specifikuar në asnjë pikë që stafi nuk mund të jetë i njëjtë për të dyja llotet. Edhe po të ishte kështu, kjo do të ishte një kërkesë e paprecedentë dhe në kundërshtim me normat juridike. Në përgjigjen tjetër ndaj pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me analisten e projektit, duke mos e arsyetuar fare, ndër të tjera thuhet se është mendim unanim nga DSISH se diploma e analistes së projektit, znj. Valentina Haziri, nuk plotëson kriteret e parapara në dosjen e tenderit. Ky vlerësim është tepër subjektiv. Përkundrazi ne si operator ekonomik kemi ofruar fakte dhe prova që vërtetojnë se znj. Haziri plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Në vijim, ne do të paraqesim kundërshtimet tona të detajuara, të cilat janë të bazuara në Ligjin e Prokurimit dhe aktet nënligjore përkatëse. Po ashtu, do të ofrojmë fakte dhe argumente që vërtetojnë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me legjislacionin në fuqi dhe është i paarsyeshëm ndaj kompanisë sonë. Pika e parë e eliminimit dhe pretendimi ankimor Kapaciteti teknik dhe profesional; Sqarim në lidhje me plotësimin e kësaj pike nga ana e OE: Na lejoni të sqarojmë se kemi plotësuar në tërësi kriteret që Autoriteti Kontraktues (AK) ka konsideruar si të pa plotësuar. Konkretisht, kemi ofruar analisten e projektit, znj. Valentina Haziri, e cila përmbush plotësisht kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për

kontratë. Ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, për Lot-in 1, pika b.1 (një), "Analist i projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës dhe Telekomunikacionit ose Master i Shkencave ose Inxhinierisë Kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft .NET me SQL Server)," ne kemi ofruar një kandidaturë që plotëson të gjitha kërkesat për këtë pozitë. Znj. Haziri është e diplomuar në fushën e kërkuar dhe po ashtu ka një diplomë Master, e cila është e përshtatshme për pozitën e kërkuar në këtë projekt. Kemi ofruar dëshmi të plota, duke përfshirë diplomën e saj Bachelor dhe Master, si dhe certifikime të shumta (cilat janë) në fushën e Analizës dhe Menaxhimit të Projekteve si dhe eksperiencë shumë vjeçare (më shumë se sa që është kërkuar (5 vite)), jo vetëm ekspertizë lokale, por edhe në sferën ndërkombëtare (Projekte nga US, Zvicër, etj) të cilat plotësojnë kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Nëse shqyrtojmë kërkesën e dosjes së tenderit, ajo specifikon mundësinë për të ofruar një Master në shkencat ose inxhinierinë kompjuterike. Kandidati ynë është një Master në Shkencat, me titull të studimeve të thelluara në fushën e Teknologjisë së Informacionit, që përputhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e pozicionit. Dallimet që mund të kenë titujt akademikë mes institucioneve janë të natyrshme, por përmbajtja dhe fusha e studimeve është pothuajse e njëjtë, me disa dallime të papërfillshme që nuk ndikojnë në përmbushjen e kërkesave të tenderit. • Të dy titujt përfaqësojnë fusha të inxhinierisë teknologjike, • Të dy titujt përfshijnë elemente të teknologjisë së informacionit dhe përdorimin e saj për zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve dhe infrastrukturave, • Të dy titujt përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve teknologjike dhe rrjetave që përfshijnë informacionin dhe telekomunikacionin, • Të dy titujt lidhen me studimin dhe aplikimin e sistemeve teknologjike, qoftë në nivelin e infrastrukturës, softuerëve ose sistemeve të komunikimit. Në këtë rast, ne konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka pasur mundësinë të kërkojë informacione shtesë ose plotësuese për të sqaruar çdo pasiguri në lidhje me përputhshmërinë e titujve akademikë, në mënyrë që të shmanget interpretimi i gabuar i dokumentacionit. Duke pasur parasysh parimet themelore të Ligjit të Prokurimit Publik, të cilat përfshijnë QËLLIMIN e realizimit të kontratës në mënyrë efektive dhe të drejtë, ne besojmë se ndonjë devijim i vogël në këtë rast nuk do të ndikonte në realizimin e qëllimit të kontratës, mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike për autoritetin kontraktues. Kjo do të mundësonte një përfundim të suksesshëm të procesit të tenderimit pa ndikim në cilësinë e realizimit të kontratës. Po ashtu, gjatë vlerësimit nga ana e AK, nuk është përfillur fare Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, konkretisht pika 2 dhe pika 4, ku thuhet se: 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Pika e dytë e eliminimit dhe pretendimi ankimor Arsyetimi i eliminimit ne kete pikë nga AK: Ju keni ofruar te njëjtin staf për te dy llotet edhe pse ne DT kanë qen te ndara kriteret e kërkuara për stafin e angazhuar ne këtë projekt, dhe si te tillë nuk e plotëson

kriterin e kërkuar në FDT. Sqarimi nga OE: Në rastin konkret, na lejoni të sqarojmë se kjo paraqet një vlerësim të padrejtë dhe në kundërshtim me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ne si operator ekonomik kemi ofruar stafin ashtu siç është kërkuar për të dyja llotet, duke respektuar kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Sidoqoftë, askund në dosjen e tenderit nuk është specifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe taksative se nuk mund të ofrohet stafi i njëjtë për të dyja llotet. Përkundrazi, në dosjen e tenderit nuk ka ndonjë kërkesë të qartë që e ndalon angazhimin e të njëjtit staf për më shumë se një llot, dhe as një përcaktim të ndarë të kriterëve për stafin që angazhohet në secilin llot. Ky vlerësim dhe arsyetim i bërë nga ana e Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), veçanërisht me nenin 59, i cili përcakton qartë procedurën për "Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahësimin e Tenderëve". Ky nen kërkon që procedurat të jenë të qarta, të parashikueshme dhe të drejtpërdrejta në çdo fazë të prokurimit. Eliminimi i operatorit ekonomik në këtë pikë është i papranueshëm dhe i paarsyeshëm, sepse ai nuk është mbështetur në ndonjë bazë të ligjshme, dhe është rezultat i një interpretimi të paqëndrueshëm të kërkesave të dokumenteve të tenderit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka përfillur në mënyrë të plotë dhe të saktë kriteret dhe kërkesat që vetë ka përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ky veprim është një shkelje e rëndë e parimeve të LPP-së dhe ka krijuar një vlerësim të paqartë, të paarsyeshëm dhe tendencioz ndaj ofertës sonë. Në këtë mënyrë, vendimi i autoritetit kontraktues është i pabazuar dhe nuk reflekton një vlerësim të drejtë dhe transparent të ofertës sonë. Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues Neni 1 - Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Në rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se: 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Në rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm që nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se: 1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do

të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 2 dhe 4 e këtij neni Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm, qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen, konkretisht pika 2 dhe 4 i cili thotë se: 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Konsiderojme se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara si të tilla Refuzohen dhe mbetet në fuqi vendimi i AK. Në lidhje me pretendimet e juaja është mendimi unanim i përgjegjesve nga DSISH që diploma e ofruar për analisten e projektit znj. Valentina Haziri - master në menaxhimin e projekteve, nuk e plotëson kriterin e kërkuar në DT. Në dokumentin e tenderit, tek seksioni "KERKESAT për kapacitetin teknik", është përcaktuar si kriter i domosdoshëm: a. 1 (një) Analist i Projektit 4 Inxhinier i diplomuar në fushën e Kompjuterikës me Telekomunikacion ose me diplomë Master në Shkenca ose Inxhinieri Kompjuterike, me përvojë pune minimale 5-vjeçare pas diplomimit në rolin e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft.NET me SQL Server). Dëshmitë e kërkuara: Kopje e diplomës CV e nënshkruar nga inxhinieri Deklaratë për caktimin e Analistit të Projektit Kontratë pune me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhimin në këtë projekt OE, në dokumentacionin e dorëzuar, ka ofruar si analist projektin një kandidat me diplomë "Bachelor of Information Technology and Systems" dhe "Master in Project Management", të cilat nuk përmbushin kriteret e kërkuara akademike të përcaktuara më sipër. Gjithashtu, është kërkuar që kandidati të ketë të paktën 5 vite përvojë pune pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike të zhvilluara në platformën Microsoft .NET me SQL Server. Nga shqyrtimi i CV-së së paragitur, rezulton se kandidati nuk zotëron përvojën e kërkuar në këtë fushë specifike. (faqe 31- 34) E rikonfirmojmë konstatimin e komisionit vlerësues se oferta juaj është e papërgjegjshme për të dyja Lotet, pasi që Tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa Për Lot-in 1 (një) Analist i projektit Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën Microsoft (NET me SQL Server). Ju keni ofruar për Analiste të projektit znj. Valentina Haziri e cila ka ofruar një diplomë bachelor të teknologjisë informative si dhe një diplomë master në menaxhimin e projekteve, diplomë e cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar në DT. Ju keni ofruar të njëjtin staf për të dy lotët edhe pse në

DT kanë qenë të ndara kriteret e kërkuar për stafin e angazhuar në këtë projekt, dhe si e tillë nuk e plotëson kriterin e kërkuar në DT.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0262, ndërsa me datë 24.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0262, me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar me rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Cactus Sh.a., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0262, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim shtesë: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimet të cilat janë ngritur me ankesë janë shqyrtuar nga eksperti dhe i njëjti ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: “Kemi plotësuar në tërësi kriteret që Autoriteti Kontraktues (AK) ka konsideruar si të pa plotësuar. Konkretisht, kemi ofruar analisten e projektit, znj. V.H., e cila përmbush plotësisht kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, për Lot-in 1, pika b.1 (një), "Analist i projektit - Inxhinier i diplomuar i Kompjuterikës dhe Telekomunikacionit ose Master i Shkencave ose Inxhinierisë Kompjuterike, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në cilësinë e analistit të sistemeve softuerike (të zhvilluara në platformën 5/4 Microsoft .NET me SQL Server)," ne kemi ofruar një kandidaturë që plotëson të gjitha kërkesat për këtë pozitë. Dallimet që mund të kenë titujt akademikë mes institucioneve janë të natyrshme, por përmbajtja dhe fusha e studimeve është pothuajse e njëjtë, me disa dallime të papërfillshme që nuk ndikojnë në përmbushjen e kërkesave të tenderit.”

Eksperti shqyrtues sqaron që në dosjen e tenderit tek pjesa e kapacitetit teknik dhe profesional, pika b.1 është kërkuar që operatorët pjesëmarrës të kenë të angazhuar një analist të projektit-Inxhinier i diplomuar i kompjuterikës me telekomunikacion ose Master i shkencave ose inxhinierisë kompjuterike me përvojë pune 5 vjeçare. AK ka eliminuar OE ankues në lidhje me këtë kërkesë duke sqaruar se për kërkesën e lartpërmendur është ofruar diplomë bachelor e teknologjisë informative si dhe një diplomë master në menaxhimin e projekteve të cilat nuk i plotësojnë kriteret e dosjes.

Pas pretendimit të ngritur, eksperti ka analizuar ofertën e OE ankues sa i përket kësaj kërkesë të dosjes së tenderit dhe tutje sqaron që në ofertën e operatorit ankues (pika 13. Staf i propozuar) për pozitën- Analist i projektit janë dorëzuar dy diploma për znj. V.H., diploma e parë e studimeve themelore përmes të cilës është marrë titulli Bachelor në teknologji informative dhe sisteme dhe e dyta është diploma e studimeve Master në menaxhimin e projekteve. Sa i përket diplomës së studimeve themelore sqarojmë që kjo diplomë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit për arsye se nuk mund të konsiderohet drejtim i njëjtë me inxhinierinë kompjuterike sa do të ngjashme që mund të duken në shikim të parë, këto dy drejtime kanë dallime me njëra tjetrën dhe se diploma e dorëzuar mund të konsiderohet e ngjashme me inxhinier të kompjuterikës por nuk mund të konsiderohet e njëjtë me një inxhinier të diplomuar të kompjuterikës ashtu siç ka qenë edhe kërkesa e dosjes. Në anën tjetër, e mirëqenë nuk mund të merret as diploma e studimeve master e cila ka të bëjë me një fushë krejtësisht tjetër nga ajo e kërkuar. Andaj, në këtë pikë vlerësojmë që pretendimi i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 2

“Arsyeja e dyte e eliminimit ka të bëjë me stafin e angazhuar. Ne si operator ekonomik kemi ofruar stafin ashtu siç është kërkuar për të dyja llotet, duke respektuar kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Sidoqoftë, askund në dosjen e tenderit nuk është specifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe taksative se nuk mund të ofrohet stafi i njëjtë për të dyja llotet. Përkundrazi, në dosjen e tenderit nuk ka ndonjë kërkesë të qartë që e ndalon angazhimin e të njëjtit staf për më shumë se një llot, dhe as një përcaktim të ndarë të kriterëve për stafin që angazhohet në secilin llot.”

Me pretendimin e ngritur eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht kërkesat e parashtruara nga AK në lidhje me stafin i cili do të angazhohet dhe sqaron që në kërkesat e FDT-së në lidhje me stafin janë parashtruar kërkesa të veçanta për stafin i cili duhet të angazhohet në Lot 1 dhe Lot 2. Ku për Lot-1 janë kërkuar gjashtë punonjës ndërsa për Lot-2 katër të tjerë. Nëse e marrim parasysh Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, shohim se në këtë aneks janë përmbledhur Modulet e caktuara dhe objektivat e përgjithshme për të dyja lotet, aktivitetet të cilat duhet të realizohen në të njëjtën kohë. Përderisa kërkesat për stafin e të dy Loteve kanë qenë të ndara dhe të veçanta, atëherë mendimi i ekspertit është që operatorët pjesëmarrës është dashur të ofrojnë dokumentet e nevojshme për secilin lot veç e veç sa i përket stafit profesional sipas kërkesave të dosjes. Në këtë pikë konsiderojmë që pretendimi i ngritur nga OE ankues është i pabazuar.

Andaj, nga sqarimet e dhëna më lartë sqarojmë që pretendimet se dispozitat e caktuara të ligjit-LPP janë shkelur nuk qëndrojnë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe

parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Cactus" Sh.a. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Cactus" Sh.a., janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik duhet refuzohet si e pabazuar dhe mbet në fuqi, Vendimi i autoritetit kontraktues për shpërblim me kontratë operatorin ekonomik OE "Data ProgNet" Sh.P.K, për aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN", me numër të prokurimit; 206-25-90-2-1-1.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit

kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0262, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe se vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës është marrë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, vlersimi i ekspertit shqyrtues, të cilin e mbështet paneli shqyrtues dhe konstatohet se OE i rekomanduar për kontratë i përgjegjshëm, e ka plotësuar kriteret e Dosjes Tenderti.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës të OE "Cactus" Sh.a, vendosi ti konfiskoj tarifën e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - " Cactus " Sh.a.**
- Arkivës së OSHP-së: